



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:182614

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747177

KPPP.nr. 2205/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit Kompania e Sigurimit “Sigkos” Sh.A., me numër unik identifikues 811292979 dhe me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Vali” Sh.P.K., me numër të unik identifikues 81168550 dhe me seli në Glllogovc, Kamaran, p.n., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 212/22 i datës 17.03.2022, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Valdrin Beka nga Prishtina, jashtë seancës me datën 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Vali” Sh.P.K., ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr. 212/22 i datës 17.03.2022, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Valdrin Beka, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania e Sigurimit “Sigkos” Sh.A., me datë 17.03.2022 ka lëshuar urdhrin P.nr. 212/22, duke lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit Faturës nr. 04690/21, e datës 17.09.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin t’ia paguajë kreditorit shumën prej 1,362.90 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbareimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbaremore me arsyetim se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbaremore nuk është nënshkruar nga debitori dhe i njëjti nuk ka qenë i njoftuar për

detyrimin që rrjedh nga kjo faturë. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim janë të pa bazuara për faktin se debitori ka nënshkruar polisën e sigurimit përmes së cilës është bërë sigurimi i ekzekutimit të tenderit, ashtu që pas lidhjes së sigurimit sipas polisës është lëshuar fatura nr. 04690/21, e datës 17.09.2021 e cila përmban nënshkrimin e njëjtë si në kontratën e sigurimit. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkak që si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se fatura nr. 04690/21 e datës 17.09.2021, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë, dhe e njëjta i është bashkëngjitur propozimit për përmbartim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si e tillë paraqet bazë për lejimin e përmbartimit pasi që është e përshtatshme për përmbartim.

Gjykata pati parasysh pretendimet e ngritura nga debitori si në prapësim por që ky i fundit, nuk ka ofruar asnjë provë siç përcaktohet me nenin 69 par.4 të LPP-së, për të dëshmuar ekzistimin e një prej shkaqeve taksative nga neni 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2205/23, datë 28.05.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.